



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 293, datë 30.05.2023

PËR

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z. {...}
TË KRITEREVE LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN
DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONET E LIRA TË SHPALLURA
ME VENDIMET NR. 500 DHE NR. 501, DATË 21.11.2022, SI DHE NË GJYKATËN
E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, PËR POZICIONIN E LIRË
NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 503,
DATË 21.11.2022 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E
PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË
KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 30.05.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kandidatit, z. {...}”, përkatësisht nga relatori z. Klodian Kurushi, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 500, nr. 501 dhe nr. 503 datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.500, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”

2. Me Vendimin nr. 501, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...

3. Me Vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës në fushën e të drejtës penale.

4. Në këto procedura ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit Durrës, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 21.11.2022, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 05.12.2022.

5. Brenda afatit të kandidimit, për pozicionet e lirë të shpallur me vendimet si më sipër, ka kandiduar gjyqtari z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

6. Me Vendimin nr. 66, datë 09.02.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë: 12. Për kandidatin z. {...} - relator z. Klodian Kurushi.

7. Më datë 10.02.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

8. Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Më datë 23.02.2023, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatit iu dërgua formularët dhe autorizimet përkatëse si dhe Autorizimi “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe Deklarata “Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale”, sipas pikës 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, meqenëse verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidat do të kryhet nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, bazuar në nenin 6 dhe nenin 57 pika 11 të Ligjit të ligjit 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

10. Brenda afatit pesëditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

10.1 Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 09.03.2023, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndër ta edhe për kandidatin z. {...}. Për këto kriterë ligjore kandidimi procedurat e verifikimit janë në proces e sipër.

11. Për këtë kandidat, është kërkuar informacion pranë strukturës së posaçme të Këshillit, në lidhje me verifikimet e kryera në zbatim të Ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, meqenëse në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kandidati ka qenë gjyqtar dhe i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Ky verifikim është në vijim e sipër si dhe do ti përcillet për kompetencë Komisionit të Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, duke qenë se verifikimi i figurës për pozicionet në gjykatën e posaçme, për këtë kandidat, është objekt i veprimtarisë së tyre.

12. Sipas pikës 9, të Vendimeve të Këshillit nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “b”, “ç” dhe “d” të pikës 5 të këtij vendimi, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional:...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimeve të Këshillit nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përcaktohen ..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “b”, “c” “ç”, dhe “d” të pikës 5, të këtyre vendimeve, përcaktohet se: *“b) Kandidati duhet të japë pëlqimin (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; c) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e*

verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”; ç) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; d) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

13. Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr. 503 datë 21.11.2022, është përcaktuar se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr. 503 përcaktohet se: “Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës penale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: “c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

14. Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për kandidatin z. {...}, u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

14.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr.1732/3 prot., datë 09.03.2023, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

14.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nënkriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ai ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës penale/drejtësinë kriminale, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht në: i) Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (stazhi profesional), ii) Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe iii) Gjykatën e Apelit Vlorë informacioni iu kërkua këtyre gjykatave. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë informacioni i kërkuar është përcjellë nëpërmjet postës elektronike, më datë

07.04.2023, siç do të përshkruhet më poshtë; nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë informacioni i kërkuar është përcjellë nëpërmjet postës elektronike, më datë 20.03.2023; nga gjykata e apelit të juridiksionit të përgjithshëm informacioni është përcjellë nëpërmjet postës elektronike, më datë 12.04.2023 siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR KRITERET E KANDIDIMIT

15. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

16. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022, është parashikuar si kriter kandidimi, në nenin 47, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: *“Për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

17. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 503 datë 21.11.2022, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

18. Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, u mbajt parasysh se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale (referuar sa më sipër), duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës penale.

19. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2010, ndërkohë që ai është emëruar si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (stazhi profesional) për periudhën 27 shtator 2010 deri në 21 dhjetor 2011, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme. Në vijim ai është emëruar gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku vijon të ushtrorë funksionin dhe aktualisht. Me vendim nr. 404, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet për të shërbyer si pjesë e skemës

së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, detyrë të cilën e ka ushtruar deri më 01.02.2023, kur u krijua Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

20. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 08.07.2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2010.

Me dekret nr. 6689, datë 27.09.2010 të Presidentit të Republikës caktohet për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekret nr. 7201, datë 21.12.2011 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Me vendim nr. 404, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet për të shërbyer si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për periudhën deri në datë 07.10.2021.

Me vendim nr. 413, datë 29.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ricaktohet për të shërbyer si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për periudhën deri në datë 07.10.2022.

Me vendim nr. 407, datë 04.10.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ricaktohet për të shërbyer si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për periudhën deri në datë 01.02.2023 dhe në vijim ushtron funksionin e magjistratit (gjyqtar) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 12 vite.

Z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

21. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 503 datë 21.11.2022 rezulton të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë dhe mbi 2 (dy) vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtar i skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

22. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kandidatin z. {...}, rezulton si vijon:

Janar 2010 - Dhjetor 2010	Proces	Përfunduar
Civile Themeli	9	0
Urdhra ekzekutimi	0	76
Gjithsej	9	76

Janar 2011-Dhjetor 2011	Proces	Përfunduar
Civile Themeli	1	45

Kërkesa Civile	0	1
Urdhra ekzekutimi	0	86
Dosje Penale	0	2
Lejim Votimi	0	3
Gjithsej	1	137

23. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se nga verifikimet e kryera prej tyre, pranë gjykatës ndodhen të administruara urdhra me shkrim të kryetarit të gjykatës, sa i përket ndarjes në dhoma/seksione të gjyqtarëve prej vitit 2012. Nga urdhrat e kryetarëve të gjykatës të cilat gjenden pranë gjykatës përkatëse, rezulton se z. {...}: në vitet 2012, 2013 ka qenë gjyqtar pranë seksionit civil; në vitet 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019 gjyqtar pranë seksionit penal;

23.1 Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e apelit e juridiksionit të përgjithshëm, rezulton nga verifikimet e kryera prej tyre, se gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, nuk kanë qenë të ndarë në seksione. Në këto rrethana gjyqtari {...} ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve (penale, civile).

24. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimet e Këshillit nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 503 datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

25. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “Dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

26. “Dhënia e pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” si kriter për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022, është parashikuar në nenin 47, pika 3, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i cili në fakt është një dispozitë referuese e cila referon konkretisht në nenin 48, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, që përcakton se: “1. Përpara emërimit, kandidatët për gjyqtarë dhe pozicione të tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të

organizuar, kandidatët për prokurorë dhe pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët për drejtor, zëvendësdrejtor, hetues, oficer të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit firmosin deklaratën përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi (jetë private) në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare, të dhënë në shtojcat B1 e B2 të këtij ligji. Kjo deklaratë firmoset përpara se ata të caktohen me detyrë apo të punësohen. 2. Anëtarët e afërt të familjeve të personave të përmendur në pikën 1 gjithashtu firmosin deklaratën përkatëse për heqjen dorë nga të drejtat, të dhënë në shtojcën B3 të këtij ligji, si tregues se i kuptojnë kushtet... ”.

27. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar , kandidati ka depozituar:

- Formularin “Vetëdeklarim (i gjyqtarëve dhe prokurorëve)”, Shtojca B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidati, z. {...}, i datës 05.12.2022;
- Formularin “Vetëdeklarim (i anëtarëve të familjes së gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; i prokurorëve dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme; i drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesit, oficerit të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicioneve të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit”, Shtojca B, Deklarata 3, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga bashkëshortja e kandidatit, znj. Ejona Lazellari, i datës 05.12.2022.

28. Sa sipër, Këshilli vlerëson se rezultoi nga verifikimi se kandidati, dhe familjarët e tij të afërt, konkretisht bashkëshortja, në respektim të përcaktimeve ligjore, kanë dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve përkatëse tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, duke plotësuar kështu kriterin e “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

29. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

30. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë dhe si kriter për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 500, nr. 501 dhe nr. 503 datë 21.11.2022, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

31. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masa disiplinore në fuqi”.

32. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

33. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

34. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

35. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “d”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 500, nr. 501 dhe nr. 503 datë 21.11.2022, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”.* Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”.* Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.*

36. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit *“Për situatën e papajtueshmërisë ambientale”* datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

37. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

38. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z. {...} Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast

të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

39. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimeve Këshillit nr. 500, nr. 501 dhe nr. 503 datë 21.11.2022 nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të kriterëve formale të kandidimit të z. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

40. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak kriterëve formale të kandidimit për kandidatin z. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore në procedurën e ngritjes në detyrë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 500, nr. 501 dhe nr. 503 datë 21.11.2022.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4 të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në shkronjën “a” të pikës 2 dhe në pikën 3 të nenit 47, në pikën 7 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 500, datë 21.11.2022 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, Vendimin e tij nr. 501, datë 21.11.2022; “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, Vendimit të tij nr. 503, datë 21.11.2022; “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës në fushën e të drejtës penale” pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i tij, z. Klodian Kurushi,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 500, nr. 501 dhe nr. 503 datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 503 datë 21.11.2022.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR